

LETËRGARANÇIONI

Kurdo që lidhni kontrata afariste që kërkojnë garancione të cilat ju do t'i përmbushni detyrimet tuaja, ne do të jemi të kënaqur për ta diskutuar opsionin e Letërgarancisë. Letërgarancionet e lëshuara nga TEB-i mbështeten në traditën dhe ekspertizën e gjatë të kompanive tona mëmë, TEB A.S dhe BNP Paribas. Letërgarancioni mund të përdoret për kontrata vendore dhe ndërkombëtare pasi që TEB-i ju ofron llojet në vijim:

Garancioni i Tenderit – është një dokument që kërkohet në fazën e aplikimit për një tender pasi që kjo garanton se produkti ose shërbimi do t'i ofrohet përfituesit sipas detyrave dhe përgjegjësive në dosjen e tenderit. Qëllimi i Garancionit të Tenderit është që t'i tregojë blerësit se Tenderi është një ofertë serioze dhe se pala që e dorëzon këtë do ta nënshkruajë kontratën nëse pranohet Tenderi.

Garancioni i Ekzekutimit – siguron se përfituesi (një palë në një kontratë) do t'i pranojë produktet ose shërbimet specifike nga kontraktori, ashtu siç janë përshkruara në marrëveshjen e tyre.

Garancioni i Pagesës me Avans – është një formë e sigurisë nga pala që e pranon avansin, ndaj palës që e jep pagesën me avans, se shuma e dhënë avans do t'i kthehet nëse marrëveshja nuk mund të përmbushet për të cilën është dhënë avansi.

Garancioni i Pagesës – ofron siguri financiare për përfituesin, nëse aktori dështon në realizimin e pagesës për mallrat ose shërbimet e pranuar. Ky është një lloj i zotimit financiar që kërkon nga debitori t'ia kthejë borxhin në përputhje me termet dhe kushtet që aplikohen në marrëveshjen fillestare për borxhin. Nëse debitori dështon në përmbushjen e obligimit të tij/saj, atëherë Banka do ta paguajë shumën financiare të specifikuar në kontratë.

Garancionet e tjera në TEB me kërkesë të konsumatorit (gjithmonë sipas formulimit dhe marrëveshjes së pranuar të Bankës).

Garancionet e lëshuara nga TEB-i janë garancione “me kërkesë” dhe se paguhen që në kërkesën e parë. Të gjitha pagesat e realizuara sipas garancionit të lëshuar nga TEB-i duhet të procesohen përmes TEB-it si dhe t'i referohen numrit përkatës të referencës.